

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për krime të rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët, Hajnalka Veronika Karpati, kryetare-gjyqtare e Eulex-it, Driton Muharremi e Vahid Halili, anëtarë-gjyqtarë vendorë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Andres Parmas, zyrtar ligjor i EULEX-it , procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit S.T. për shkak të dy veprave penale Blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje e paautorizuar e drogave të rrezikshme dhe substancave psikotropike, parashikuar me nenin 229 par.1,2,3 dhe 4 të Kodit Penal të Kosovës (KPK) dhe veprës penale Krim i organizuar parashikuar me nenin 274 par.1,2,3 të Kodit Penal të Kosovës (KPK), duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorit Special të Republikës së Kosovës dhe ankesës së mbrojtësit të akuzuarit S.T., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.690/2011 datë 15.02.2013, në seancën e kolegjit të mbajtur me 11.12.2013 mori këtë:

#### A K T V E N D I M

- 1. Ankesat e Prokurorit Special të Republikës së Kosovës dhe të avokatit mbrojtës të të akuzuarit S.T., pranohen pjesërisht.**
- 2. Aktgjykimi i Gjykatës Themelore të Prishtinës, i datës 15 shkurt 2013 në lëndën penale nr. 690/11 anulohet.**
- 3. Lënda i kthehet në rigjykim Gjykatës Themelore të Prishtinës.**
- 4. Vazhdohet paraburgimi ndaj S.T., në përputhje me nenin 424 (6) të KPPK-së.**

#### A r s y e t i m i

1. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë P nr. 690/11 i dt. 15 Shkurt 2013, i akuzuari S.T., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale: Krim i organizuar nga neni 274 par. 1 ,2 dhe 3 të KPK-së, për çka është gjykuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 3 vitesh. Po ashtu të akuzuarit i është vazhduar paraburgimi deri sa aktgjykimi të merr formën e prerë por jo më shumë dënimi i shqiptuar me anë të këtij aktgjykimi, dhe atë konform nenit 187 par. 1 nën. par. 1.1 ,1.2 dhe 1.2 .1 të KPK-së. Koha e kaluar në paraburgim nga data 01 Korrik 2011 do ti llogaritet në dënimin e shqiptuar. I akuzuari është detyruar të paguaj shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 500 € Me këtë aktgjykim i akuzuari S.T. konform nenit 364 par. 1 nënpar. 1.3 të KPK, është liruar nga akuza për shkak të dy veprave penale blerje, posedimi, shpërndarjes dhe shitjes së paautorizuar të drogave të

rrezikshme dhe substancave psikotropike në bashkëkryerje nga neni 229 par. 1, 2,3 dhe 4 lidhur me nenin 23 apo 25 të Kodit Penal të Kosovës .

2. Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë kanë paraqitur:

- Prokurori Special i Republikës së Kosovës, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljen e kodit penal si dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, duke propozuar që kjo Gjykatë, të mbështes dënimin për të dënuarin për Akuzën 3, të modifikoj aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe ta dënoj të pandehurin për aktakuzat 1 dhe 2 dhe sipas mënyrës shtesë të përgjegjësisë për Akuzën 3, apo si alternativë të ri urdhëroj rigjykim në tërësi apo pjesërisht.

-Mbrojtësi i të akuzuarit, av. Ramë Dreshaj, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljeve së ligjit penale dhe vendimit për dënimin duke propozuar ndryshimin e aktgjykimin të ankimuar në pjesën dënuuese, duke liruar të akuzuarin S.T.n edhe nga aktakuza për veprën penale krim i organizuar nga neni 274 par. 2 të KPK, ndërsa pjesa liruese e aktgjykimin të vërtetohet, ose të anulohet aktgjykimin vetëm në pjesën dënuuese duke ia kthyer çështjen gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

3. Gjykata e Apelit e Kosovës e caktoj dhe e mbajti seancën kolegjit konform dispozitës së nenit 390 par.1 të KPP, për të cilën i njoftoj palët. Në seancë prezantoi Prokurorja e Apelit-Eulex-it Eva Judit Tatrai, i akuzuari S.T. dhe mbrojtësi i tij av. Rame Dreshaj. Prokurorja e Apelit e mbështeti propozimin e bërë me shkrim PPA/I.nr.101/13 datë 10.07.2013 me të cilin ka propozuar që të refuzohet si e pabazë ankesa e av. Ramë Dreshaj, të aprovet ankesa e prokurorit special dhe ta ndryshoj aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë: të shpall fajtor S.T.-n, për blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje të paautorizuar të narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike sipas nenit 229 par. 2 dhe 4 nën par. 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së , (pika 1 dhe 2), të shpall fajtor S.T.-n për krim të organizuar për përgjegjësi të modifikuar penale të kualifikuar me nenin 274 par. 1 ose 3 të KPK. I akuzuari e mbështeti mbrojtësin e tij.

4. Gjykata e Apelit shqyrtoi shkresat e kësaj lënde, studioi aktgjykimin e kundërshtuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP dhe pas vlerësimit të pretendimeve ankimore konstatoi:

- ankesat janë pjesërisht të bazuara dhe se aktgjykimin duhet anuluar dhe të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

5. Prokurori Special në ankesën e tij ndër të tjera pretendon se sa i përket akuzës së parë, konsideron se ekziston shkelje e dispozitave të procedurës penale pasi që ekziston një mungesë e konsiderueshme e konsekuencë në mes të dispozitivit dhe të gjeturave dhe arsyetimit faktik në aktgjykim, po ashtu konsideron se gjykata nuk ka vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike duke dështuar në vërtetimin e provës materiale përkatësisht nga provat e paraqitura trupit gjykues me arsye ka mundur të vendos për natyrën dhe sasinë e dorës në shtator të vitit 2009 . Derisa është e vërtetë se nuk është gjetur dorgj nga policia e Kosovës në lidhje me dërgesën e shtatorit 2009 dhe prandaj nuk ka pasur prova të fornezikës , megjithatë janë paraqitur prova të mjaftueshme lidhur me natyrën e drogës që deklarohet të jetë heroin si dhe sasia e dërgesës .
  
6. Provat sa i përket përbërjes së sasisë së substancave të pretenduara janë siguruara nga diskutimet e të pandehurve gjatë bisedave nën përgjim ligjor kur ata flasin për çmimin e drogës dhe pagesave që duhet të bëhen për korrierët kur e bëjnë shpërndarjen e saj , për veç kësaj është dhënë deklarata e dëshmitarit K.G. si udhëheqës i hetimeve në këtë rast , i cili qartë ka theksuar konkluzionin e tij se droga ka qenë heroinë i cili konkludimi është bërë në analizimin e bisedave të pandehurve lidhur me çmimin dhe pagesave për korrierët e në bazë të përvojës së tij të madhe me luftimin e krimeve që kanë të bën me drogën.
  
7. Po ashtu këtu për fshihet dhe biseda në të cilën X. dhe A. janë marr vesh për angazhimin e korrierëve e ku thirrja më e rëndësishme ishte me 1 shtator 2009 ndërmjet X.T. dhe me bashkëpunëtorin e tij kriminal në Shqipëri., në bazë të përvojës së tij dëshmitari ka theksuar se këto shpenzimet korrierësh përputhen me transportimin e heroinës. Prova për çmimin e dorës vijnë nga bisedat e përgjuara ndërmjet X.T. dhe H.T. me 13 shtator 2009 ku X. u informua se fitimi nga dërgesa e shtatorit ishte 86.000 € dhe se ky fitim përputhet me pretendimet se droga e transportuar nga grupi në shtator 2009 ka qenë heroinë. Prokurori po ashtu pretendon e në rastin konkret kemi shkelje penal duke zbatuar një ligj të pazbatueshëm për veprën penale nga neni 229 të KPK-së. Do me thanë është argumentuar se edhe nuk është ditur lloji i sasë së narkotikut dhe sasia e dërguar në shtator 2009 ka pasur dëshmi të mjaftueshme për tej dyshimit të arsyeshëm që të pandehurit kanë kryer veprën penale. Nëse gjykata është e bindur për tej dyshimit të arsyeshëm se të pandehurit kanë blerë, poseduar, shpërndarë dhe ose shitur narkotikë bazuar në të gjitha provat ; nuk është e domosdoshme për neni 229 të KPK që të vërtetoj llojin dhe sasinë e saktë të këtyre narkotikëve përtej dyshimit të arsyeshëm me analizën forenzike ose prova të ngjashme. Prokuroria ka provat përtej dyshimit të arsyeshëm që ka pasur një dërgesë të narkotikëve të paligjshëm në muajin shtator narkotikët nuk janë konfiskuar pasi që ky grup kriminal i ka fshehur

me sukses dhe ka bërë dërgesën në Zvicër . Sa i përket akuzës 2 prokurori pretendon se kemi shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 402 par.1 të KPP lidhur me nenin 403 par.12 dhe vërtetim të gabuar të gjendjes faktike lidhur me nenin 402 par.3 të KPP. Është e paqartë nga aktgjykimi se përse S.T. është lirua nga Akuza 2, kur analizohen gjetjet faktike të bëra lidhur me dënimin e tij për Akuzën 3. Natyrisht, prokurori mendon se gjetjet faktike nga Gjykata e shkallës së parë janë të mjaftueshme për Gjykatën e Apelit ta modifikuar si duhet Aktgjykimin gjithashtu ta fus dënimin e të pandehurit për Akuzën 2. Në aktgjykimin, Trupi gjykues deklaroi se ka konstatuar se ka qenë një grup i organizuar kriminal, dhe se grupi ka kryer një krim të rëndë, respektivisht transportimin e 109 kg. Të kanabisit në Nëntor 2009. Ai gjithashtu ka konstatuar se TOPUZI “ka marrë pjesë” në dërgesë duke siguruar transportin për aktivitetet e grupit. Konstaton se TOPUZI ka ditur për aktivitetet kriminale të grupit, dhe me qëllim u ka kontribuar atyre (faqe 21 faktet e provuara).

8. Për më tepër, gjetjet faktike nga gjykata e shkallës së parë mbështesin gjithashtu dënimin për Akuzën 2. Domethënë, Paneli gjen se “përgjimi i telefonit provon se S.T., X.T., H.T., A.T., G.G., A.K. dhe G.I. kanë bashkëpunuar bashkë në dërgimin e arkatikëve. Shpërndarja dhe përgjegjësitë nuk ishin të rastësishme. G.G. dhe S.T. ishin përgjegjës për transportin. “(faqe 23). Më tutje, u vendos se “përgjimi dhe telefonatat në mesë G.G., S.T., X.T., A.T. dhe video dokumentimi nga vëzhgimi tregojnë se rreth 25 Nëntorit 2009 S.T. ishte shumë mirë në dijeni të aktiviteteve të grupit” dhe “I pandehuri ishte shumë mirë në dijeni që aktivitetet e tij për grupin kanë kontribuar në kryerjen të (një) krimi të rëndë nga grupi i organizuar kriminal” (faqe 25). 25 Nëntori 2009 është datë kyçe, pasi që është data në të cilën kanabisi ishte marrur nga korrierët nga Shqipëria në rrugë për Kosovë dhe e konfiskuar nga autoritetet e policisë Shqiptare. Është rast i prokurorisë që S.T. bashkë me G.G. kanë organizuar dhe mbështetur transportin nga korrierët. Kjo është e mbështetur nga të gjeturat faktike më lartë të Trupi gjykues në rend të parë. Trupi gjykues në faqe 25 të aktgjykimit deklaroi se S.T. ka pranuar që ai ka siguruar shërbime për G.G. dhe e kishte siguruar gjykatën me dokumentacion në lidhje me transportin e Elbit. Në faqen 26 trupi gjykues e arsyetoi “aktivitetet e vetme të provuara transporti i mallrave (dërgesa e narkotikeve nuk ishte dëshmuar) nuk është në shkallë të aktiviteteve të grupit të organizuar kriminal veprimi më i rëndë. Të gjeturat e trupit gjyles në lidhje me dërgesën e Nëntorit janë dhënë krejtësisht të paqarta dhe jokonsistente me vërejtje. Në dispozitiv për gjatë tërë aktgjykimit trupi gjykues ka gjetur që S.T. nuk ka transportuar drogë megjithatë ka vendosur që ai ka siguruar disa shërbime transporti gjatë periudhës së dërgesës së Nëntorit. I vetmi gjësend (përpos narkotikëve) i përmendur në aktgjykim që është transportuar është elbi. Nga aktgjykimi, duket se përfshirja e pranuar e TOPUZIT në dërgesën e elbit shihet si dëshmi e përfshirjes së tij në “kontributin e ditur në kryerjen e krimi të rëndë nga grupi” përmes përfshirjes në “aktivitetet tjera të tyre”. Megjithatë trupi gjykues nuk shpjegon në ndonjë pikë të aktgjykimit se si

transportimi i elbit mund të barazohet me përfshirjen kryerjen e krimit të rëndë e cila si pasojë është lënë në supozim. Prokurori vë në dukje se ky mund të jetë ndonjë gabim i paqëllimshëm (gabim material) nga trupi gjykues në transkriptimin e aktgjykimit në atë prej shpalljes gojore të aktgjykimit me sa duket turpi gjykues ka zbritur pretendimin e të pandehurit që mallrat që transportoheshin nga ai ishin vetëm elbi, por në Anglishten e zakonshme konkludimi është i zymtë. **Aktgjykimi në përputhje me rrethanat është i paqartë apo konsistent** në pjesë të madhe. Shkelje e ligjit penal (Neni 402 (2) i KPPK-së lidhur me nenin 404 (4) i KPPK-së për zbatimin e një ligji të pazbatueshëm për veprën penale. Prokurori vlerëson se i pandehuri S.T. do të duhej të dënohet për Akuzën 2 në bazë të konstatimeve të lartcekura (shih paragrafin 34 dhe 35), **po të mos bëhej interpretimi dhe zbatimi i gabueshëm esencial i ligjit penal që është bërë nga trupi gjykues.** Respektivisht Trupi gjykues më tej thekson se “”pjesëmarrje e drejtpërdrejtë” e Sylejman Topzit në dërgesën e cannabis sativa në Nëntor 2009 nuk është provuar (faqe 21). Aktgjykimi përshkruan se pikëpamja e trupit gjykues se çka nënkupton “pjesëmarrje e drejtpërdrejt. Ai deklaroi se kjo nënkupton “vërtetimi i një lidhje shkakore ndërmjet veprimeve të qëllimshme të të pandehurit dhe pasojave që kanë ngjarë “ (faqe 21). Termi “pjesëmarrje e drejtpërdrejt “ nuk gjendet në Kodin Penal të Kosovës. Rrjedhimisht Trupi Gjykues ka aplikuar një test që nuk mund të gjendet në ligjin penal të Kosovës në vlerësimin e veprimeve të S.T. nga pikëpamja ligjore. Megjithatë, sipas dispozitivit të aktgjykimit, Trupi gjykues ka shpallur S.T-n fajtor për shkak të “pjesëmarrjes aktive” në krim të organizuar sipas Nenit 274 (2) të Kodit Penal të Kosovës .Trupi gjykues deklaroi se “një person i cili merr pjesë në aktivitetet tjera të grupit kriminal, për shembull duke kryer transportin, është përgjegjës për veprën penale sepse ai me vetëdije i ka kontribuar kryerjes së veprës së rëndë penale nga grupi i organizuar kriminal” (faqe 21). Prandaj ekziston një mospërputhje ndërmjet dispozitivit të aktgjykimit dhe deklarimit të arsyeve. Dallimi ndërmjet “pjesëmarrjes aktive” dhe “pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë” është gjithashtu i paqartë. Më tej është gabim ligjor që të konsiderohet organizimi dhe kryerja e transportit për një grup të organizuar kriminal në cilësinë e korrierit të drogës si “pjesëmarrës jo i drejtpërdrejt”, nëse ekziston një dallim i tillë ligjor. Më tej prokurori thekson se i pandehuri ka qenë i akuzuar sipas Akuzës 2 si alternativë, si plotësisht e lejueshme sipas ligjeve të Kosovës. Madje edhe nëse Trupi Gjykues nuk e ka konsideruar at si përgjegjës penalisht për qëllimet e nenit 229 paragrafët 2,2 dhe 3 si bashk-kryes në bazë të nenit 23 të KPK-së, ka menduar që ta dënoj at në mënyrën e rregullt për ndihmesë të qëllimshme në kryerje të veprave penale sipas Nenit 25 të KPK-së. Në të vërtetë në konstatimet faktike të Trupit Gjykues, S.T. me qëllim ka ndihmuar grupin kriminal në kryerjen e veprës penale të nenit 229 të KPK-së. Kështu që ai do të duhej të dënohej për akuzën 2 në këtë bazë dhe prandaj Gjykata e Apelit mund të modifikoj aktgjykimin.

9. Prokurori në ankesë është i mendimit se trupi gjykues ka dështuar të përcaktoj dënimin e të pandehurit në mënyrën e duhur, duke e dënuar

atë për krim të organizuar sipas nenit 274 paragrafi 2 i KPPK-së. Në veçanti kjo vepër bartë një dënim të detyrueshëm prej “së paku pesë vitesh” burgim. Dënimi i të pandehurit me tri vite burgim për një krim kaq të rëndë përbën gabim ligji.

10. Më tej, derisa KPPK mundëson të trupi gjykues të marrë rrethana lehtësuese në shqyrtim në lidhje me dënimin, prokurori vlerëson se dispozitat për uljen e dënimit nuk janë zbatuar në mënyrën e duhur në aktgjykim. Në këtë pikëpamje prokurori thekson rëndësinë e konstatimeve të Trupit Gjykues se i pandehuri ka qenë anëtarë “**i pazëvendësueshëm**” i grupit të organizuar kriminal (faqe 23). Në një rast të tillë, argumentohet se fakti se i pandehuri në kohën e dënimit të të moshuarve dhe të sëmurëve (si arsye që jepen në uljen e dënimit në faqet 25 dhe 26) nuk justifikon shqiptimin e dënimit më të ulët sesa minimumi statutor prej pesë vitesh. Në të vërtetë një ulje e tillë e dënimit dërgon një mesazh jo të mirë për shoqërinë sa i përket pjesëmarrjes në një grup të organizuar kriminal, në kundërshtim me qëllimin e qartë ligjor. Më tej faktorët e tillë janë zbatuar në mënyrë më të duhur kur është shqyrtuar mundësia e lirimit të hershëm të burgosurve në vuajtje të dënimit.
11. Rrjedhimisht, prokurori kërkon që Gjykata e Apelit të modifikoj dënimin e shqiptuar për Akuzën 3 dhe ti shqiptoj dënimin minimal prej 5 vitesh burgim kundër të pandehurit.
12. Prokurori mendon se trupi gjykues ka aplikuar gabimisht ligjin e procedurës penale, kështu që nga dispozitivi gjegjësisht faqe 22 është e qartë se është zbatuar KPPK i ri i vitit 2012 në shqyrtim kryesor pas datës 01.01.2013 dhe se ky është një gabim ligjor. Prej hyrjes në fuqi të KPP-së 2013 nuk është e qartë se cilin kod trupi gjykues e ka zbatuar deri në shpalljen e aktgjykimit. Gjatë seancave prokurori ka pohuar mendimin se KPPK i vjetër nga viti 2003 të vazhdoj të zbatohet meqenëse aktakuza është konfirmuar sipas kodit të vjetër dhe gjykimi kryesor ka filluar para hyrjes në fuqi të kodit të ri. Kjo pasi dispozita e nenit 541 të KPP ka statusin e Lex specialis kufizuar në rastet ku seanca kryesore ende nuk ka filluar. Ndërsa nenit 545 është dispozit Lex generalis që nënkupton se data për parashtrimin e aktakuzës është faktori kryesor përcaktues nëse duhet zbatuar kodi i ri apo i vjetër. Pra konsideron se kodi i vjetër ka vazhduar të zbatohet gjatë kohës së gjykimit dhe për këtë ankesë. Ky ndërtim i dispozitave kalimtare të KPP mbështetet edhe nga mendimi 56 /13 i Gjykatës Supreme të Kosovës i datës 23.01.2013.
13. Ankesë ka ushtruar edhe mbrojtësit i të akuzuarit av. Ramë Dreshaj, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljeve së ligjit penale dhe vendimit për dënimin duke propozuar ndryshimin e aktgjykimit të ankimuar në pjesën dënuese, duke liruar të akuzuarin S.T.n edhe nga aktakuza për veprën penale krim i organizuar nga neni

274 par. 2 të KPK, ndërsa pjesa liruese e aktgjykimit të vërtetohet, ose të anulohet aktgjykimi vetëm në pjesën dënuese duke ia kthyer çështjen gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

14. Mbrojtësi ngrit çështjen e juridiksionit penal të Kosovës në këtë rast dhe te se a është kompetente prokuroria Speciale e Kosovës të ndërmarr një ndjekje kundër të mbrojturi të tij e po ashtu edhe Gjykata e Qarkut në Prishtinë ta mbshtesë me vendimet e veta një ndjekje penale të tillë si dhe të merret me këtë çështje penale të pa qenë siq ka ndodhur kur e dihet se i mbrojturi i tij është shtetas i R. Shqipërisë dhe nuk ka kryer as një vepër penale në territorin e Kosovës e as jashtë territorit të Kosovës në dëm të saj apo të qytetarëve të saj. Neni 99 i KPK, shumë qartë e rregullon se ndaj kujt ka veprim Kodi penal duke e cituar të njëjtin. Për mbrojtjen është dyshim dhe i pabazë kërkesa për fletë arrestim ndërkombëtar në bazë të së cilës u arrestuar dhe u ekstradua nga autoritetet policore të Kroacisë nga fakti se në shkresa potencohet se në këtë procedurë hetimore janë përfshirë disa shtete ndër do edhe Shqipëria. Prokuroria speciale e Kosovës, ka pasur bashkëpunim me prokurorinë e Krimeve të rënda në Tiranë , sidomos në kërkesën për ndihmë ligjore ndërkombëtare të dt. 18 dhe 23 . 09. 2009, dhe shtohet pyetja se mos vall prokuroria e Kosovës ka “kompetencë” ti kontrolloj organet shoqërore të Shqipërisë kur ata nuk kanë gjetur inkrinuese te shtetasi i tyre –te i mbrojturi im .
15. Dispozitivi i aktgjykimit në pjesën dënuese është i pakuptueshëm, kundërthënës në brendinë e tij ose me arsyet e aktgjykimit, është në kundërshtim me vet veten dhe nuk janë paraqitur arsyet me faktet vendimtare, ndërsa ato të paraqitura janë plotësisht të paqarta dhe kundërthënëse . Kjo mbështetet në faktin se në arsyetim në pjesën dënuese faqe 12 në nr. 3 ceket prova e paraqitur nga mbrojtësi dhe nën A) , provat materiale ku numërohen deri në numrin 28 ndërsa nën B) , deklarata e dëshmitarit S.H. dhe nënë 4 deklarata e të pandehurit S.T., me ç’rast gjykata në faqen 22 të aktgjykimit në pjesën dënuese konstaton se gjetjes e gjykatës (6) të gjitha provat janë të pranueshme , Në të njëjtën faqe në mënyrë të gabuar dhe të kundërligjshme konstaton faktet e provuara “ ekzistimi i një grupi të organizuar është provuar në masë të mjaftueshme. Kryerje e krimit të rënda nga ky grup kriminal do të thotë dërgesa e narkotikëve në nëntor 2009 gjithashtu është provuar, e po ashtu edhe pjesëmarrja e të mbrojturrit tim duke siguruar transportin për aktivitetet e këtij grupi, dijenia e tij për aktivitete kriminale të grupit të organizuar kriminal dhe kontributi i tij i qëllimshëm në këto aktivitete është provuar. Ky konstatim i gjykatës nuk mund të qëndroj pasi që nuk është vërtetuar asnjë vepër penale që kishte me u cilësua si krim i rëndë sipas ligjit e që kusht qenësore për tu cilësuar si krim i organizuar.
16. Gjykata në të njëjtën faqe , drejtë konstaton faktet që nuk janë provuar dhe atë, për fshirjen e tij me dërgesën e heroinës në shtator të vitit 2009 dhe pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë në dërgesën e canabis sativa në

nëntor 2009, dhe kjo vërtetohet më së miri se i mbrojturi im nuk ka kryer as veprën penale krim i organizuar.

17. Shkelje tjetër të dispozitave të procedurës kemi edhe me rastin e cilësimit juridik të veprës penale nga se nuk qëndron me kodin penal të Kosovës vepra penale krimi i organizuar nga neni 274 par. 2 të KPK, veç është vërtetuar se i mbrojturi im nuk ka kryer vepër penale –krim të rëndë për të cilën parashihet dënimi me të paktën 4 vite.
18. Sipas nenit 7 , gjykata , prokurori dhe policia detyrohen që ti vërtetojnë faktet në tërësi të cilat janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm dhe që me vëmendje dhe përkushtim maksimal profesional dhe me përkujdesje të njëjtë të vërtetojnë faktet kundër të pandehurit si dhe ato në favor të tij. Gjykata që në fillim të shqyrtimit ka bërë prejudikimin se i mbrojturi im është fajtor dhe kryes i veprës penale për të cilën kishim filluar shqyrtimin duke u rreshtuar në anën e prokurorisë duke bërë konstatime të gabuara në procesverbal për të cilat mbrojtja disa herë ia ka tërhequr vërejtjen në këtë drejtim.
19. Gjykata e shkallës së parë konform nenit 396 apr. 7 të KPPK, është dashur që paraqesë në mënyrë të qartë dhe të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsye i konsideron të vërtetuar apo të pavërtetuar si dhe arsyet për këtë e të cilat në aktgjykimin e anikimuar në pjesën dënuese nuk e ka bërë.
20. Mbrojtja e të akuzuarit konstaton se është bërë vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike, pasi që një mori elementesh faktike dhe qenësore nuk janë vlerësuar drejtë e nëse janë vlerësuar janë vlerësuar në bazë të kriterëve të një anshme. Kjo argumentohet me kundërthëniet që ekzistojnë në dispozitat ligjore respektivisht nenin 274 të KPK, dëshmisë së dëshmitares V.G. e cila për herë të parë ka dëgjuar për S.T.n , në seancën kryesore si dhe dëshmitari i mbrojtjes S.H. i cili në mënyrë decidive ka deklaruar se hetuesi K.G., jo vetëm që i ka stërmadhuar gjërat por janë edhe të pavërteta ato që ai ka raportuar gjatë hetimit në këtë çështje penale si dhe dëshmia e K.G. i cili asnjë herë nuk ishte në gjendje gjatë procedurës penale ta vërtetonte se ndonjë herë S.T. është kapur me substancë narkotike, disa herë ka kërkuar falje se nuk është zëri i tij gjatë dëgjimit së përgjimeve se nuk është fjala për S.T.n edhe pse në përgjime dhe transkripta përmendet “ baca “ apo “baca Sul”
21. Mbrojtja konsideron se kemi edhe shkelje të ligjit penale si pasojë e shkeljeve të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike , respektivisht vlerësimi i gabuar i fakteve dhe provave. Bazuar në këtë ai duhet liruar na akuza në mungesë të provave njëjtë siç është liruar në pjesën liruese të aktgjykimit.
22. Sa i përket vendimit mbi dënim aktgjykimi është i kundërligjshëm ngase me vet faktin e shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës



penale mos vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike si dhe shkeljes së ligjit atëherë dashtë e pa dashtë gjykata e shkallës së parë i është diktuar edhe vet shkelja e ligjit penal. Gjykata nuk ka trajtuar fare rrethanat lehtësuese por ka vendosur me bindje të vetë të paqëndrueshme. I akuzuari si në prokurori ashtu edhe në gjykatë është paraqitur në mënyrë të sinqertë, korrekte dhe të emancipuar për kundër asaj që është i moshës së shtyrë edhe pse ka mohuar veprën penale vetë faktet që gjenden në shkresat e lëndës.

23. Prokuroria e Apelit me parashtresën PPA/I nr.101/13, të dt. 10 Korrik 2013, ka propozuar që ta refuzoj si të pabazë ankesën e av mbrojtës Ramë Dreshaj, të aprovoj ankesën e prokurorit special dhe ta ndryshoj aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë: të shpall fajtor S.T.n, për blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje të paautorizuar të narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike sipas nenit 229 par. 2 dhe 4 nën par. 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së , (pika 1 dhe 2) apo të shpall fajtor S.T.n për krim të organizuar për përgjegjësi të modifikuar penale të kualifikuar me nenin 274 par. 1 ose 3 të KPK.
24. Qysh në fillim Gjykata e Apelit jep pajtimin e saj me vlerësimin e prokurorit se Gjykata Themelore gabimisht ka zbatuar një sërë rregullash të gabuara procedurale kur ka marrë udhëzime nga KPP-ja. Pasi që aktakuza në lëndën aktuale është konfirmuar në pajtueshmëri me KPPK dhe shqyrtimi gjyqësor filloi para hyrjes në fuqi të KPP-së, e tërë lënda duhet të gjykohet sipas rregullave përkatëse të KPPK-së. Ky konstruksion është mbështetur edhe me Mendimin 56/13 të Gjykatës Supreme të datës 23.01.2013.
25. Gjykata e Apelit vlerëson se dispozitivi i aktgjykimit është i pa kuptueshëm dhe i paqartë nuk përkon me arsyetimin dhe faktet vendimtare të paraqitura nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Nuk është e qartë se cilat fakte janë shpallur të vërtetuara nga gjykata e shkallës së parë dhe nuk ekziston përshkrimi faktik i cili do të sqaronte se cili veprim i të akuzuarit është vërtetuar. Gjykata e shkallës së parë ka përshkruar bisedat nga përgjimet e bëra, por nuk ka dhënë vlerësimin dhe arsyetimin e tyre dhe se me cilat veprime të akuzuarit që dalin nga këto përgjime i njëjti involvohet në veprën penale për të cilën është shpallë fajtor.
26. Gjykata e shkallës së parë vlerëson se i akuzuari është përgjegjës pasi që ai e ka ditur se ka bashkëpunuar me njerëz që merren me krim të organizuar e që është evidente nga biseda telefonike e përgjuar e datës 28.07.2009 në mes të akuzuarit dhe H.T.t, ku i akuzuari ka thënë se nëse nuk i merr të hollat që ia kanë borxh do ta shes veturën, e cila temë rreth kësaj veture është diskutuar nga X.T. dhe A.T. të njëjtën mbrëmje, për të cilën gjykata e konsideron si shumë tepër të lartë për një transport të ligjshëm, pa e cekur sa është kjo shumë për të mundur të konsiderohet e lartë si dhe konstatimet se një shofer nuk do të përdorte një stil të tillë negocimi me fjalët „ mi jep të hollat ose do ta shes veturën” si dhe fakti se kamioni i të akuzuarit është shumë i

rëndësishëm për pjesëtarët e grupit dhe se i akuzuari është për të tjerët i pazëvendësueshëm, është vetëm një supozim i pa mbështetur dhe arsyetuar mjaftueshëm.

27. Dispozitivi sa i përket veprave penale nën pikën 1,2 dhe 3 të këtij aktgjykimi janë thjeshtë vetëm parafrzim të Kodit, nga të cilat dispozitave nuk mund të përcaktohet se cilat janë aktivitetet kriminale të akuzuarit. Këtë bindje të gjykatës së Apelit e forcon edhe fakti se gjykata e shkallës së parë ka marrë aktgjykim lirues për veprat bazë Blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje e paautorizuar e drogave të rrezikshme dhe substancave psikotropike, parashikuar me nenin 229 par.1,2,3 dhe 4 të Kodit Penal të Kosovës (KPK) ndërsa ka shpallur fajtor të akuzuarin për veprën penale Krim i organizuar parashikuar me nenin 274 par.1,2,3 të Kodit Penal të Kosovës (KPK). Kjo gjykatë vlerëson se vepra penale Krim i organizuar parashikuar me nenin 274 par.1,2,3 të Kodit Penal të Kosovës (KPK), si e vetme nuk mund të qëndrojë pa të ashtuquajturin „krimin bazë” si krim i rëndë e që është kusht që një vepër penale të përbëjë veprën penale të Krimit të organizuar sipas nenit 274 të KPK-së. Për këtë arsye, përgjegjësia për veprën penale të krimit të organizuar nuk mund të konstatohet pa u konstatuar së pari përgjegjësia penale për veprën e rëndë penale. Po ashtu mbetet e pa qartë nëse gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar se është transportuar diçka si dhe mbetet e pa qartë cilësia e asaj nëse mund të quhet substance e cila është transportuar, pasi që nga shkresat e lëndës shihet se vetëm supozohet lloji i substancës narkotike, e që kjo është vërtetuar nga eksperti, i cili një konstatim e bie në bazë të bisedave telefonike duke bërë pjesëtimin në mes të sasisë dhe çmimit të kontraktuar, pa e pasur fare substancën fizikisht.
28. Gjykata e shkallës së parë ka lirinë e veprimit rreth vlerësimit të provave ndërsa Gjykata e Apelit vetëm bën rivlerësimin e provave nëse gjen gabime në vlerësimin e gjykatës dhe se vetëm në raste të jashtëzakonshme bën administrimin e provave me hapjen e shqyrtimin në shkallë të dytë. Kjo gjykatë ka gjetur se përshkrimi faktik nuk është bërë sa duhet në aktgjykim dhe se arsyetimi është i pamjaftueshëm. Pasi që është e pa qartë se çfarë janë gjetjet e Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe mënyra se si kjo gjykatë ka ardhur deri te përfundimet e këtilla, Gjykata e Apelit, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.
29. Gjykata e Apelit është e mendimit se ankesat e prokurorit dhe avokatit mbrojtës duhet të pranohen pjesërisht. Kolegji pajtohet me prokurorin se ekzistojnë kundërthënie në mes të arsyetimit dhe dispozitivit sikurse sqarohet me paragrafin 25 të këtij aktgjykimi. Këto kundërthënie rezultojnë nga arsyetimi jo i plotë dhe vërtetimi jo i drejtë i gjendjes faktike. Vëmendje e posaçme duhet t'i kushtohet faktit se shumë nga provat e përgjuara nuk janë vlerësuar aspak nga Gjykata Themelore.
30. Edhe argumentet e paraqitura në ankesën e avokatit mbrojtës për vlerësim të gabuar të pretenduar të fakteve janë për çështjen në pjesën

që konkluzionet e Gjykatës Themelore janë kundërthënëse; gjykata në realitet nuk ka arsyetuar qartë cilat fakte janë konsideruar të konfirmuara e cilat nuk janë konsideruar të konfirmuara.

31. Pasi që, bazuar në këtë që u tha më lart Gjykata e Apeli është e mendimit se për shkak të shkeljeve të rënda procedurale dhe mangësive serioze në vërtetimin e fakteve lënda duhet të kthehet në rigjykim, kolegji i apelit nuk do të trajtojë argumentet e ankesës së prokurorit lidhur me dënimin e S.T. ose shoshit më tej argumentimin e ankuesit lidhur me vërtetimin e gabuar të pretenduar të fakteve dhe zbatimin e gabuar të ligjit substantivë.
32. Gjykata e Apelit i konsideron të pa merita argumentet e avokatit mbrojtës në lidhje me mungesën e pretenduar të kompetencës së gjykatave të Kosovës për të gjykuar faktet në fjalë. Në këtë aspekt çështja e kompetencës së gjykatave të Kosovës tashmë është trajtuar në fazat e mëhershme të lëndës.
33. Nga arsytet e sipër cekura aktgjykimi i ankimuar juridikisht është i paqëndrueshëm dhe si i tillë është dashtë të anulohet dhe çështja ti kthehet Gjykatës së shkallës së parë për rigjykim. Në rigjykim Gjykata e shkallës së parë duhet të veproj në pajtim me vërejtjet e lartcekura, t'i eliminoj të gjitha shkeljet e cekura, t'i administroj të gjitha provat dhe të njëjtat t'i vlerësoj në pajtim me dispozitën e nenit 370 par.6 dhe 7 të KPP, dhe varësisht nga rezultati i vlerësimit të provave të nxjerr konkluzione të drejta të ligjshme e të bazuara në provat e administruara e mandej të merr vendim përkatës.
34. Po ashtu meqë aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P.nr.504/2010 datë 4 korrik 2011, kundër të akuzuarve X.T., A.K. dhe G.I., e që ndërlidhet edhe me të akuzuarin S.T., është anuluar dhe i është kthyer gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje me aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës , Ap.nr.448/2001, ky kolegji propozon që gjykata themelore, konform nenit 35 të KPP, të bëjë bashkimin e procedurës penale të akuzuarve X.T., A.K. dhe G.I. me atë të akuzuarit S.T. dhe ndaj tyre të udhëhiqet një procedurë e vetme.
35. Sa i përket paraburgimit, kolegji penal i kësaj gjykate duke vepruar konform nenit 402 par.4 të KPP, vendosi që të akuzuarit ti vazhdohet paraburgimi, pasi që konsideron se ende ekzistojnë kushtet dhe rrethanat për të cilën edhe është caktuar i njëjti.
36. Nga çka u tha më lart, e në pajtim me dispozitën e nenit 402 të KPP u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

*Përgatitur në gjuhën shqipe, gjuhë e autorizuar. Aktgjykimi i arsyetuar është përfunduar dhe është nënshkruar më datë 13 janar 2014.*

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS  
PAKR.nr.148/2013, më 11.12.2013

Procesmbajtësja,  
Andres Parmas

Kryetarja e kolegjit – gjyqtarja,  
1. Hajnalka Veronika Karpati

Anëtarët e kolegjit:

2. Driton Muharremi\_\_\_\_\_

3. Vahid Halili\_\_\_\_\_